

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE BORDI

Gjatë muajit qershor Bordi i ERE-s ka zhvilluar 3 mbledhje, që kanë rezultuar në 20 vendimmarrje, ndër të cilat:

- Licencimin e shoqërisë "5GX ENERGY" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, shoqërisë "AYEN AS ENERGJI" sha në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar secila, si dhe si dhe rinovimin e licencës së shoqërisë "GSA" shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 23.12.2024.
- Licencimin e shoqërisë "FU-GEN" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2MW, dhe vendndodhje në Qarkun Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Shtyrjen deri në 30 ditë të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "5GX ENERGY" shpk për licensim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Pranimin e kërkesave të shoqërive:
 - "MALIDO - ENERGJI" sh.p.k, "SMART WATT" shpk dhe "TIRANA ENERGJI" për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e secilës shoqëri.
 - "HYDROBORSH" sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, "BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE" sha, me kusht që shoqëria të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj. "HYDROBORSH" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të saj fikse për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj palës kredidhënëse "BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE" shpk.
 - "SMART TRADE & CONSULTING" sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Nova Prospect" shpk në veprimtarinë e prodhimit të enegjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2MW, dhe vendndodhje në qarkun Vlorë; dhe shoqërisë "AGE ERZEN" shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Hekali", me kapacitet të instaluar 1940 kW, dhe vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë
- Ndryshimin e pikës 1 në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022 "Mbi licencimin e shoqërisë "SPV BLUE 1" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik "Blue 1", me kapacitet të instaluar 50MW, për një afat 25 vjeçar, duke filluar nga data 23.05.2024", datë në të cilën shoqëria ka dokumentuar testimin dhe energjizimin e këtij centrali fotovoltaik.
- Shfuqizimin e pikës 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 17, datë 06.02.2024 "Mbi kërkesën e shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si kolateral për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, si rezultat i plotësimit të kushtit të paracaktuara në vendimmarrje.

Të plota këto vendime gjenden të publikuara faqen tonë zyrtare: www.ere.gov.al

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIME

RAPORTI VJETOR

Disa nga vendimet e marra gjatë muajit qershor lidhen me autoritetin e ERE për përcaktimin e çmimeve si dhe ndryshime të nevojshme në rregullat e tregut të energjisë elektrike. Të tilla janë vendimet si vijon:

- Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2024 prej 10.73 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Në faqen e ERE gjenden të publikuara cmimet e miratuara nga ERE, të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për çdo muaj, në zërin Tarifat
- Pranimin e kërkesës së Bursës Shqipëtare të Energjisë, shoqërisë Alpex sh.a., për disa ndryshime në Aneksin 3 të Rregullave të tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, ndryshime këto që reflektojnë shtesat dhe ndryshimet në kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara me VKM nr.46 datë 31.01.2024.

Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).

Kryetari i ERE-s, z. Petrit Ahmeti, prezantoi më 27 qershor në Kuvendin e Shqipërisë, Raportin Vjetor të ecurisë së sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror dhe të veprimtarisë së ERE për vitin 2023, i cili paraqet një përshkrim të detajuar si dhe të dhëna specifike mbi ecurinë e sektorëve, duke pasqyruar në mënyrë krahasimore treguesit e këtij viti me vitet parardhës

Në Kuvend pati argumente pozitive, por dhe kritika dhe replikë, ndër të cilat Z. Pëllumbi dhe disa prej anëtarëve të tjerë të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, përgëzuan punën e bërë nga ERE për gjetjen e ekuilibrit mes shtetit, biznesit dhe konsumatorit, për funksionimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), e cila filloi operimin në orën 00:00 të datës 12.04.2023, për transparencën, diversifikimin e burimeve të energjisë, rritjen e volumeve të energjisë të tregtuar në Bursën Shqiptare të Energjisë, trendin e uljes së humbjeve të energjisë në sistemin e shpërndarjes, për memorandumet e nënshkuara për bashkimin e tregut të një dite në avancë brenda vitit 2026 etj. Sa pasqyruar në Raport, u vlerësua si një kapërcim i madh i pasojave negative të lëna pas nga vitet e tranzicionit përsektorin energjitik, ku inkurajues është prodhimi i energjisë nga prodhues të vegjël. Komisioni gjithashtu paraqiti Rezolutën për vitin e ardhshëm për Entin Rregulator të Energjisë, me 12 rekomandime, mbi të cilat ERE do të mbështesë objektivat e saj në vazhdim. Kopje e këtij raporti gjendet e publikuar në faqen e internetit të ERE në linkun e mëposhtëm:

<https://www.ere.gov.al/sq/publikime/raporte-vjetore>.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

KONSULTIME

Pjesë e aktivitetit të ERE-s kanë qënë dhe 5 seanca dëgjimore të zhvilluara për zgjidhjen e ankesave dhe marrjen e qëndrimeve të palëve, si dhe me subjekte të licencuara, me qëllim sqarimin e paqartësive dhe për të rezultuar me një vendimmarrje më të plotë.

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me të dhënat e fundit të tregut të energjisë në vend, regjistrat e licencimit të subjekteve, të garancive të origjinës dhe të ankesave të rifreskuar, si dhe tarifa dhe çmime të miratuara nga ERE.

Në zërin konsultime, ju ftojmë gjithashtu të lexoni materiale e mëposhtme mbi të cilat mund të dërgoni opinionin tuaj si palë interesi, në adresën tonë të e-mailit erealb@ere.gov.al:

1. Propozim për miratimin e "Metodologjisë për përcaktimit e tarifave për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)"
2. Marrëveshje për Mbështetje
3. Implementimi i intervalit kohor 15 minuta për proceset e tregut balancues në zbatim të Rregullave Shqiptare të Balancimit
4. Për disa shtesa e ndryshime të Rregullores për Lidhjet e Reja

FORUME DHE TRAJNIME



Gjatë muajit që lamë pas, përfaqësues të ERE-s, kanë marrë pjesë në konferenca, trajnime dhe forume kombëtare dhe ndërkombëtare, ku përmendim Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit si dhe Konferencën IV Kombëtare për të Drejtën e Informimit, të organizuara nga KDIMDP; Forumin e Energjisë Nukleare si dhe Takimin e përvitshëm të Oficerëve Ndërlidhës, organizuar nga ERRA; apo dhe trajnimet intensive të organizuara nga USAID dhe NARUC mbi integrimin e koncepteve GESI dhe DEIA, dhe avancimin e femrave lidere në sektorin e energjisë.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MEDREG

Presidentët e Autoriteteve Rregullatore Kombëtare të MEDREG, të mbledhur në Selinunte gjatë Workshopit të 4-të të MEDREG, mbajtur më 12 Qershor 2024, diskutuan bashkërisht evolucionin dhe dinamikën e sektorit të energjisë në rajonin e Mesdheut, ndanë një perspektivë të përbashkët mbi evolucionin e ardhshëm të tregjeve të energjisë dhe shprehën përkushtimin për të bashkëpunuar mes tyre. Situata e Mesdheut kërkon veprime aktuale dhe fleksibël për të kapërcyer sfidat e ndryshme dhe për të arritur zhvillimin e kuadreve rregullatore koherente. Tranzicioni energjetik nxjerr në pah rolin vendimtar të rajonit të Mesdheut dhe është qëllimi i përbashkët garantimi i sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji në të ardhmen. Rregullatorët kanë përgjegjësinë të bëjnë sistemet energjetike të përballueshme dhe të qëndrueshme dhe janë të përkushtuar për të nxitur inovacionin energjetik, teknologjitë dhe modelet e biznesit. Infrastrukturat energjetike do të kenë një rol vendimtar në sigurimin e operimit dhe integritetit të sistemeve,



prandaj, rregullatorët duhet të përmirësojmë më tej bashkëpunimin me politikëbërësit, palët e interesit në sektorin energjetik përmes takimeve vjetore që do të organizohen në bazë rotacioni në vendet anëtare të MEDREG, për të diskutuar sfidat dhe mundësitë e përbashkëta. Presidentët e MEDREG-ut theksuan rëndësinë e paqes në rajonin e Mesdheut dhe në pjesën tjetër të botës, duke qënë stabiliteti një parakusht për të garantuar sigurimin e një kuadri të qëndrueshëm rregullator të energjisë. "Me shpresën që procesi i paqes të arrihet shumë shpejt, ne presim të bashkëpunojmë përsëri së bashku, të ulur në të njëjtën tryezë për një mjedis të begatë të Mesdheut. Është koha të kthehemi në rrënjët tona të lashta për të ardhmen e Mare Nostrum (Mesdheut) tonë!" u shprehën ata.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BASHKËPUNIME

Në datat 5 dhe 6 qershor 2024, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë zhvilloi në Athinë, Greqi, Forumin e 29-të të Komunitetit të Energjisë Elektrike, ku morën pjesë Kryetari i ERE- z.Petrit Ahmeti, Komisioneret znj. Erjola Sadusi dhe znj. Brunilda Tavani, Sekretari i Përgjithshëm z. Elton B. Radheshi si dhe përfaqësues të tjerë të grupit të punës. Cjatë forumit u diskutua mbi përpjekjet dhe sfidat e vendeve kontraktuese në transpozimin e Paketës së Integritetit të Energjisë Elektrike, duke i nxitur ata që ta përfundojnë deri në fund të vitit 2024 për bashkimin e tregut dhe përjashtimin nga CBAM. Panelistët theksuan nevojën për ekspertizë dhe burime, zhvillimin e infrastrukturës për dekarbonizim dhe mbështetje financiare për kalimin në hidrogjen. Forumi gjithashtu vuri në dukje rëndësinë e emërimeve të NEMO-ve, aktiviteteve të CCR-së dhe investimeve në energji të rinovueshme. Ata diskutuan ndikimet e CBAM, likuiditetin e tregut, teknologjitë e ruajtjes së energjisë dhe kërkuan transparencë në menaxhimin e lidhjes së rrjetit dhe rishikimet rregullatore të planeve të zhvillimit dhe tarifave.



Më 6 qershor 2024, z.Gledis Kalemi, përgjegjës sektori në Drejtorinë e tarifave dhe çmimeve, ishte pjesë e panelit të forumit “Global Energy Insights: Albania Investments & Market Trends” organizuar në bashkëpunim mes Agjensisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Dhomës Shqiptaro – Turke të Tregtisë dhe Industrisë (ATTSO). Emëruesi i përbashkët i eventit ishte sektori energjetik dhe legjislati i respektiv sa i përket investimeve, efënca energjetike, forca punëtore në sektor si dhe financimi i projekteve të ndryshme në energjinë e rinovueshme, duke u përmblyllur dhe me krijimin e ndërlidhjeve nga bisedimet e afërta mes të pranishmëve.

